



**UNIVERSITETI “ALEKSANDËR XHUVANI”  
ELBASAN**

**THIRRJE PËR PJESËMARRJE**

**KONFERENCË NDËRKOMBËTARE**

**“ PËRVOJA DHE SFIDA NË FORMËSIMIN E  
KOMPETENCAVE PROFESIONALE TË STUDENTËVE  
PËRMES PRAKTIKËS NË SHKOLLË”**

**20-21 Dhjetor 2017**

**FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT**

**Me pjesëmarrjen e:**



Reformimi i arsimit të lartë në Shqipëri dhe veçanërisht formimi fillestar i mësuesve po ndesh sfida të konsiderueshme e të ndjeshme, në të gjithë aspektet. Ndryshimet e dukshme që po ndodhin në të gjitha nivelet, sidomos reforma në arsimin parauniversitar, diktojnë konsiderimin dhe reflektimin nga IAL-et, në formimin fillestar dhe zhvillimin profesional të mësuesve. Praktika profesionale në shkollë është terreni, ndoshta më i rëndësishëm, ku studenti mbi bazën e njohurive, aftësive dhe bindjeve formëson kompetencat e profesionale. Por, a mundëson kuadri ligjor aktual i përshtatshëm sfidat që kemi? A kemi kapacitete të mjaftueshme për mentorim në shkolla? A është mjedisi shkollor mikpritës për studentët? A kanë dizenuar IAL-et paketë dokumentacioni të përshtatshme për zhvillimin e praktikave? A kemi sfida në përshkallëzimin e formësimit të kompetencave sipas fazave të praktikës profesionale? Cilat janë sfidat dhe si dokumentohet vlerësimi i studentëve në praktikat profesionale në shkolla? Cilat janë sfidat që praktika profesionale nxjerr në raport me kornizën kurrikulare në arsimin parauniversitar? Ju ftojme të ofroni ndihmesën tuaj shkencore në këtë konferencë.

### **Komiteti Shkencor**

Prof. Dr. Skender Topi (UE)

Prof. As.Dr. Valentina Haxhiymeri (UE)

Prof. As.Dr. Peçi Naqellari (UE)

Prof. As.Dr.Ardjan Turku (UE)

Prof. Dr. Fatbardha Gjini (UE)

Dr. Jonida Cungu (DAR Elbasan)

Prof. As.Dr.Florinda Tarusha (UE)

Prof. Dr. Dorina Rapti (IZHA)

Prof. Roberto Dainese (Bologna University)

Prof. Federica Zanetti (Bologna University)

Prof. Dr. Valentina Milenkova, (University "Neofit Rilski" Bulgaria.)

Prof. Dr. Edmond Rapti (UT)

Prof. Dr. Nikoleta Mita (UT)

Prof. Dr. Bardhul Musai (UT)

Prof. As.Dr.. Tomi Treska (UET)

### **Komiteti Organizator**

Prof. As. Dr. Ardjan Turku

Prof. As. Dr. Florinda Tarusha

Prof. As. Dr. Elisabeta Osmanaj

Prof. As. Dr. Ornela Bilali

Prof. As. Dr. Xhevdet Zekaj

Prof. As. Dr. Silvana Turku

Dr. Ardian Tana

Doc./Dr. Beatrice Gani

Dr. Dhurata Valera

Dr. Erjada Çela

MSc. Roksana Poçi

Prof. As. Dr. Teuta Toska

Konferenca Ndërkombëtare në Shkencat e Edukimit, në kuadër të sfidës për përgatitjen e mësuesve të dekadës së ardhshme, fton studiues, akademikë, mësues, psikologë, punonjës socialë, studentë praktikantë, agjensi qeveritare dhe konsulentë për të marrë pjesë e për të ndarë njohuritë, perspektivat dhe tendencat e reja të hulumtimeve në formësimin e kompetencave profesionale të studentëve përmes praktikës në shkollë.

### Tematikat e konferencës:

1. Rregullimi ligjor i marrëdhënieve IAL - institucione për praktikën në shkollë
2. Aspekte organizative dhe proceduriale për të siguruar sasinë dhe cilësinë e praktikës
3. Mjedisi psikosocial i praktikës në shkollat pritëse
4. Dokumentimi dhe vlerësimi i praktikës në shkollë
5. Udhëheqja e studentit në praktikën profesionale për formësimin e kompetencave të mësuesit
6. Të nxënit me bazë kompetencat në Arsimin Parauniversitar dhe praktika e mësimdhënies

### Botimet e konferencës

- Përzgjedhja e punimeve më të mira do të bëhet mbi bazën e përkatësisë me tematikat, qartësisë së mendimit dhe origjinalitetit.
- Abstraktet e punimeve të pranuar do të botohen në Librin e Konferencës (*proceedings*) me ISBN.
- Punimet, të cilat do të konsiderohen si më të arrira, do të merren në konsideratë për t'u botuar në revistë shkencore.

### Seancat që do të mbahen në konferencë:

- a) Seanca plenare
- b) Sesionet tematike
- c) Sisioni për posterat
- d) Tavolina e rrumbullakët

### Data të rëndësishme:

Dërgimi i abstraktit	<b>17 Nëntor 2017</b>
Njoftimi i pranimit të abstraktit	<b>27 Nëntor 2017</b>
Data e konferencës	<b>20-21 Dhjetor 2017</b>
Vendi	<b>Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Elbasan</b>
Gjuha zyrtare e konferencës	<b>shqip, anglisht</b>
Adresa zyrtare	<b>researchcenter.edu@yahoo.com</b>

### Informacione të rëndësishme

**Tarifa e pjesëmarrjes** është 3000 lekë për një autor; për çdo bashkautor shtohet 1000 lekë. Kjo tarifë përfshin Certifikatën e Konferencës, Librin e Proceedings të Konferencës me ISBN, dreka dhe kostot e tjera administrative.

Stafi Akademik i Universitetit “Aleksandër Xhuvani” është i përjashtuar nga tarifimi.

### Detaje teknike

- Shkrimi në formatin A4, lloji i gërmës:12 pt., font - Times New Roman.
- Punimi duhet të jetë origjinal dhe i pa publikuar më parë.
- Punimi duhet të dorëzohet në rrugë elektronike në adresën e mëposhtme, e-mail: [researchcenter.edu@yahoo.com](mailto:researchcenter.edu@yahoo.com)
- Konfirmimi për pranimin e abstraktit do të dërgohet në rrugë elektronike në adresën personale të aplikantit.

### Udhëzime për abstraktin

Abstrakti duhet të përshkruajë shkurtimisht çështjen studimore që do të diskutohet në artikull dhe të japë një përmbledhje koncize të gjetjeve.

### Kërkesat kryesore mbi abstraktin:

- **Titulli i studimit:** 12 points Times New Roman, bold, centered.
- **Emri i autorit:** Emri i plotë i autorit (autorëve), statusi, institucioni dhe adresa e-mail për secilin prej autorëve (12 points Times New Roman).
- **Përmbajtja:** Abstrakti duhet të jetë 150-250 fjalë dhe të paraqesë qëllimin dhe metodologjinë e kërkimit, rezultatet dhe rekomandimet (12 Points Times New Roman, Justified, Single-space).
- **Fjalë kyç:** 3-6 fjalë, Times New Roman, me gërma 12-she, italic.
- **Formati:** Abstrakti duhet të dorëzohet në format Microsoft Word (97-2003 document)

### Informacion shtesë

Për të dërguar abstraktin dhe punimin, për të komunikuar njoftimet për pjesëmarrjen dhe pagesat, si dhe për çdo informacion të nevojshëm, luteni të shkruani në adresën elektronike të konferencës: [researchcenter.edu@yahoo.com](mailto:researchcenter.edu@yahoo.com) **Tel: 00355 /686 909 029**

**Me kënaqësi presim t'ju takojmë në Elbasan - Dhjetor 2017!**